

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"TRIMED" shpk**



Sot me dt. 11/2004,

- **Avenir Peposhi**, i datelindjes **20.12.1979**, lindur ne **Kukes** dhe banues ne **Tirane**, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta e tij me nr. **0272085**, mbeshtetur ne Ligjin Nr.7638, date 11 nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi ka vendosur te themeloje shoqerine si me poshte".

**Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise**

**Neni 1**

Themeluesi sa siper formone shoqerine **"TRIMED"**, shoqeri kjo me pergjegjesi te kufizuara, per te zhvilluar veprimtari private. Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

**Neni 2**

Shoqeria do te emertohet **"TRIMED"** shpk.

**Neni 3**

Shoqeria do te kete Seline e saj ne Tirane Bulevardi "Bajram Curri" {stacioni i fundit i Tiranës se re", Pll -11 Kt, kati i I-re.

**Neni 4**

*Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me nje afat 10 vjet.*

Shoqeria **"TRIMED"** shpk gezon statusin e personit juridik nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te Gjykates se shkalles pare Tirane.

**Neni 5**

*Shoqeria "TRIMED" SHPK. do te kete si objekt:*

*"Veprimtari private ne fushen e importit, eksportit, rieksporimit, shitje me shumice dhe pakice te medikamenteve humane, veterinare, dentare, materiale higjensanitare, bime mjeksore, nenprodukte bimore e shtazore, ushqime per femije e diabetike {dietetike}, mmateriale e pajisje kozmetike, pajisje e linja prodhimi ne fushen e shendetsise, aparatura e pajisje mjeksore, lende te para e produkte farmaceutike e kimike, veprimtari ne rolin e komisionerit dhe perfaqesues te*

*firmave te tjera, perfshi te huaja, per drejtimet e mesiperme si dhe ne sfera te tjera te sherbimit farmaceutik”*

**Neni 6**

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj mbi baze dege ne qytete te tjera te vendit, te cilat do te hapen pasi te kete filluar dore dore aktiviteti i shoqerise.

**Neni 7**

Selia e shoqerise mund te transferohet.

**Neni 8**

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (Njeqindemije) leke, dhe ne te merr pjese vetem ortakut i vetem i saj Z. Avenir Peposhi.

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie do ti takoj ortakut te vetem te saj z. Avenir Peposhi.

**Neni 9**

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortaku i shoqerise nuk mbane pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tije qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

**Neni 10**

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.


**Neni 11**

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Themeluesi i shoqerise si e lexoi me vemendje akt themelimin e mesiperme dhe e gjeti konform vullnetit te tije e firmosi pa verejtje.

**ORTAKU THEMELUES**  
**(Avenir Peposhi)**

Avenir Peposhi



**STATUT  
PER VEPRIMTARINE E SHOQERISE**

**“TRIMED ”shpk**



*Sot me dt. 1/12/2004,*

- **Avenir Peposhi**, i datelindjes **20.12.1979**, lindur ne **Kukes** dhe banues ne **Tirane**, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta e tij me nr. **0272085**, mbeshtetur ne Ligjin Nr.7638, date 11 nentor 1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi ka vendosur te themeloje shoqerine si me poshte".

**KREU I-re**

**Dispozita te Pergjitheshme**

**Neni 1.**

Emertimi i shoqerise eshte **“TRIMED ” SH.P.K.** Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“TRIMED ”sh.p.k.** ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie ( kontraten dhe statutin) dhe legjislacionin shqiptar, Ajo rregullon poziten juridike te themeluesit dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria **“TRIMED ” SH.P.K** eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen Shoqeria **“TRIMED ” sh.p.k** Tirane . Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

**Neni 2.**

*Shoqeria **“TRIMED ” SHPK.** do te kete si objekt:*

*“Veprimtari private ne fushen e importit, eksportit, rieksportimit, shitje me shumice dhe pakice te medikamenteve humane, veterinare, dentare, materiale higjensanitare, bime mjeksore, nenprodukte bimore e shtazore, ushqime per femije e diabetike {dietetike}, mmateriale e pajisje kozmetike, pajisje e linja prodhimi ne fushen e shendetsise, aparatura e pajisje mjeksore, lende te para e produkte farmaceutike e kimike, veprimtari ne rolin e komisionerit dhe perfaqesues te firmave te tjera, perfshi te huaja, per drejtimet e mesiperme si dhe ne sfera te tjera te sherbimit farmaceutik”*

### **Neni 3.**

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane Bulevardi “Bajram Curri” {stacioni i fundit i Toiranes re} Pll 11 kat kati i pare. Ajo mund te çele dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

***Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet.***

### **Neni 4.**

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.


## **KREU II-te**

### **Te drejtat dhe detyrat e Ortakut:**

### **Neni 5.**

#### **Ortaku gezon keto te drejta kryesore:**

- Administrimin e veprimtarise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike, etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese se Ortakut dhe organet e tjera te shoqerise.
- Te heq dore nga shoqeria.
- Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tije ose vete.
- Te kerkoje ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite



ekonomike, etj.

- Te beje propozime dhe t'i paraqesi ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeroje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

**Ortaku ka keto detyrime kryesore:**

**Neni 6.**

- Te depozitoje kapitalin e nevojshem per themelimin e shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.
- T'i japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Heqja dore nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.
- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
- Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ai nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ai ka marre pjese.

**Neni 7.**


- Kur ortakun heq dore nga shoqeria ai kuotat e kapitalit te tije mund tia ofroje te treteve.

**KREU III-te**

**Kushtet Ekonomike**

**Neni 8.**

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31



Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dheeventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asamblea. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

#### **Neni 9.**

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihete nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

Ne shoqerine "TRIMED" shpk ne krijimin e kapitalit baze merr:

*Avenir Peposhi me 100% te kuotave te kapitalit e = me 100.000 leke.*

Asamblea e Ortakut dorezon nje dokument me te cilin vertetohet derdhja e shumes.


#### **Neni 10.**

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave i merr ortakut themelues . Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj.perfitohen prej ortakut themelues te kesaj shoqerie.Ortakut perballone humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te saj ortakut ka te drejten e rritjes se tije.

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektit e veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera



materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj. Shoqeria disponon mjetet e veta financiare.

Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fonde rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare qe kur deshirojne mund te derdhen prej ortakut, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

#### **Neni 12.**

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen. Shoqeria gezon te drejttat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 13.**

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta per financimin e zhvillimin e saj, per nxitjen e ekonomise ,etj.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante caktohen nga Asamblea e Pergjithshme ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria disponon plotesisht mjetet e saj financiare.


Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj, mbulohen nga fonde rezerve dhe nga fondet e tjera, ose nga shumat suplementare qe mund te derdhi ortakut, kur detyrimet nuk mund te zbulohen nga fondet egzistuese.

#### **Neni 14.**

E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbritet amortizimi i te gjitha pasurise se lujteshme e te palujteshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e pergjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, I takojne ortakeve themelues ne perpjestim me kuoten e pjesmarrjes ne kapitalin baze te shoqerise.

**KREU IV-te**

**Administrimi**



## Neni 15.

### Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakut.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga administratori i pergjithshem, nga eksperti kontabel i autorizuar ose nga likuiduesit.

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e *zakonshme* ose e *jashtezakonshme*.

Asambleja e zakonshme vendos :

1. Per ceshtje te tilla si emerim ose shkarkimin e personelit Injenero-teknik sipas strukturave te ngritura nga shoqeria ,ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesit, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, per :
2. Ndryshimet e statutit.
3. Rritjen dhe pakesimin e kapitalit baze.
4. Miratimin e programit vjetor te veprimtarise se shoqerise.
5. Per fitimin dhe rezultatet.
6. Kohezgatjen e veprimtarise se shoqerise.
7. Pushimin e veprimtarise se shoqerise.

Ne te merr pjese ortaku themelues ose perfaqesuesi i emruar prej tije per: miratimin e llogarive vjetore, te ndarjes se fitimit.

Asambleja e jashtezakonshme vendos:


Per ceshtje te tilla si ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar , shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe.

Asamblea e Ortakut te shoqerise thirret se paku nje here ne vit.

## Neni 17.

Asamblea e Ortakut merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise

Kompetencat ekzekutive te Asamblese se Ortakut te shoqerise jane:






1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne emertesen e prodhimit qe do te realizohet dhe te punimeve qe do te kryhen, qe jane pjese perberese e objektit te veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i regjimit dhe i kushteve te zbatimit te parimeve te llogarise ekonomike.
5. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
6. Percaktimi i struktures se aparatit te shoqerise.
7. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndermjet perfaqesive te ortakut.
8. Emertimi dhe zevendesimi i Administratorit te pergjithshem te shoqerise.
9. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektiveve te shoqerise.
10. Percaktimi i madhesis se kuotave per formimin e kapitalit baze te shoqerise.
11. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dhe perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tije.
13. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
14. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
15. Perzgjedhja e antareve per komisionin e likujdimit te cilet emrohen dhe rievokohen nga Asamblea e Ortakut.
16. Kryerjen e veprimtarive per likujdimin e llogarive, qe u perkasin ortakut te shoqerise.
17. Marrjen e vendimit per kerkimin dhe perdorimin e kredive afatgjata.

#### Neni 18.

Vepimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i pergjithshem i saj. Ne shoqerine **"TRIMED" SH.P.K** Administrator i shoqerise eshte Adem Nazifi i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e saj. Me miratimin e ortakut mund te emrohen administrator dhe perfaqesues te shoqerise **"TRIMED" shpk**, ndersa Drejtues teknik i saj eshte z. Pellumb Cuko.



Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tije gjate administrimit te shoqerise.

**Kopetencat e administratorit ne shoqeri jane:**

Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.

Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjen e asambles kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.

Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.

Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.

Te krijojë organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.

Te propozojë ne mbledhjen e asambles per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.

Te pergatise propozimet per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqesin ato Asamblese per miratim.

Te perzgjedhi ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit dhe te paraqesi propozimet per miratim ne asamble.

Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te asamblese.

Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.


-Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme, administron pasurine e shoqerise, duke perfshire ketu mjetet financiare, brenda caqeve te vendimeve te marra nga organi administrativ i shoqerise.

-Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.

-Perfaqson shoqerine perpara te treteve si gjykate, etj.

-Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete.

-Merr te gjitha vendimet qe kane te bejne me ato veprimtari te shoqerise, qe nuk jane ne kompetence ekzekutive te Asamblese se Ortakut.



- Raporton dhe i pergjigjet Asamblese per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.
- Siguron drejtimin e shoqerise.
- Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakut.
- Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se Ortakut.
- Ben hapjen e leter kredive ne leke e ne valute te huaj.

### **Neni 19.**

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te shoqerise e te filialeve te saj krijohet komisioni i revizionimit kontabel.

Kryetari dhe antaret e ketij komisioni emerohen nga Asamblea e Ortakut. Kryetari i komisionit emerohet per cdo mandat nga Asambleesa.

Komisioni i Revizionimit kontabel perbehet nga 3-5 vete dhe qendron ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh.

Kryetari dhe antaret e komisionit nuk mund te jene ne varesi te shoqerise ose filialeve te saj.

Komisioni i Revizionimit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet perpara Asamblese se Ortakut dhe eshte i detyruar ti paraqese asaj cdo vit raport per kontrollet e bera si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

### **Neni 20.**

#### **Marredheniet e punes ne shoqeri.**

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes.

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

• Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e Punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

• Pushimi i marredhenies se punes.

• Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

## **KREU V-te**

### **Mbyllja e Shoqerise:**

#### **Neni 21.**

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga njeri prej ortakëve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortakët heqin dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata).

Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Afati i veprimtarise se shoqerise "TRIMED" shpk eshte i pakufizuar.

Viti 2004 eshte viti i pare i veprimtarise.

#### **Neni 22.**

### **Kur shoqeria likujdohet:**

Asambleja e ortakut emerone komsionin e likujdimit, te cilit i paraqitet bilanci likujdimit dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci.


Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i takojne ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

#### **Neni 23.**

Kur pushon veprimtaria e nje filiali ,per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakut.

Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.



Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

**Neni 24.**

Ku statut hyn ne fuqi menjehere.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "TRIMED" shpk**

**Avenir Peposhi**

*Avenir Peposhi*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**NOTERIA TIRANE**

**Notere Mimoza Shehu**


**Nr. 15447 Kol.**

**Nr. 323P Rep.**

*Taksa e Pultit  
u pagua*

**VERTETIM**

Sot me daten 8/12/2004 para meje Mimoza Shehu notere ne qytetin e Tiranes, u paraqite personalisht nenshkruesi sa siper i cili deklaroi se ky statut eshte redaktuar sipas vullnetit te tij e nenshkroi ne pranine time dhe une noterja si u binda per vullnetin e deklarimit dhe identitetin e tije lejoj nenshkrimin dhe e legalizoj ate sipas ligjit.

The image shows a circular official notary seal on the left, partially overlapping a rectangular stamp on the right. The stamp contains the handwritten text "28/12/2004" and a signature. A large, loopy signature is written over the stamp and extends across the bottom of the page.